

1 E premte, 18 dhjetor 2020

2 [Paraqitja e Parë]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari Gucati hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Fillon në orën 14.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita dhe mirëserdhët
7 të gjithë brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Znj. Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita. Lënda KSC-BC-
10 2020-07, Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe
11 Nasim Haradinajt.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit znj.
13 Sekretare.

14 Tani do t'u kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve që të
15 prezantohen. Do të filloj me Zyrën e Prokurorit të
16 Specializuar.

17 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.
18 Në emër të Zyrës së Prokurorisë sot të pranishëm jemi, unë
19 Valeria Bolici, Prokurore në Zyrën e Prokurorit të
20 Specializuar; Nathan Quick, jurist; dhe Aniko -- Angel
21 Langenberg, që është ndihmës për menaxhim e çështjes.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Tani do t'i drejtohem Mbrojtjes.

24 Lëshoni mikrofonin z. Rees.

25 Z. REES: [Përkthim] Unë përfaqësoj z. Gucati. Jam

1 Jonathan Rees. Dhe ndihmësi im, në anën time të majtë i ulur,
2 është z. Huw Bouden.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

4 Për procesverbalin theksoj se i pranishëm në sallë është
5 edhe klienti juaj z. Gucati.

6 Tani i drejtohem Administratores.

7 ADMINISTRATORJA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë jam
8 Fidelma Donlon, Administratore.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.
10 Administratore.

11 Për procesverbalin, unë jam Nicolas Guillou, Gjykatës i
12 Procedurës Paraprake në këtë çështje.

13 I akuzuari paraqitet sot para Dhomave të Specializuara
14 pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij më 11 dhjetor.

15 Z. Gucati, në Paraqitjen e Parë në shtator kërkova prej
16 jush që të identifikonit veten, kështu që tani do të vazhdoj
17 drejtpërsëdrejti me historikun procedural të çështjes.

18 Më 24 shtator 2020, lëshova fletarrestim për të dyshuarin
19 pasi konstatova se ekziston dyshim i bazuar që z. Gucati është
20 penalisht përgjegjës për veprat penale në vijim: frikësim
21 gjatë procedurës penale; hakmarrje; dhe shkelje të fshehtësisë
22 së procedurës.

23 I dyshuari u arrestua në Kosovë më 25 shtator 2020 dhe u
24 transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të
25 Specializuara të Kosovës në Hagë po atë ditë.

1 Më 11 dhjetor 2020, unë si Gjykatës i Procedurës
2 Paraprake, konfirmova aktakuzën e parashtruar nga Prokurori i
3 Specializuar kundër të akuzuarit, në të cilën ai akuzohet për
4 veprat penale të mëposhtme:

5 Pika 1: Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e
6 detyrave zyrtare, me anë të kërcënimit të rëndë;

7 Pika 2: Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e
8 detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e
9 përbashkët të një grupi;

10 Pika 3: Frikësim gjatë procedurës penale;

11 Pika 4: Hakmarrje;

12 Pika 5: Shkelje të fshehtësisë së procedurës, përmes
13 zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të
14 nxjerrë në procedura zyrtare; dhe

15 Pika 6: Shkelje të fshehtësisë së procedurës, përmes
16 zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave
17 personale të dëshmitarëve të mbrojtur.

18 Aktakuza e Konfirmuar iu dorëzua të akuzuarit të hënën më
19 14 dhjetor.

20 Tani më lejoni të shpjegoj qëllimin konkret të Paraqitjes
21 së Parë për nevojat e të akuzuarit dhe atyre që na ndjekin nga
22 galeria publike dhe online.

23 Seanca e sotme nuk është gjykim. Në këtë seancë nuk do të
24 paraqiten e as debatohen prova, dhe nuk do të diskutohet
25 fajësia apo pafajësia e të akuzuarit, e as nuk do të merret

1 vendim në lidhje me të.

2 Qëllimi i kësaj Paraqitje të Parë përcaktohet në nenin 39
3 të Ligjit dhe rregullën 92 të Rregullores. Në pajtim me këto
4 dispozita, unë si Gjykatës i Procedurës Paraprake: ia lexoj të
5 akuzuarit akuzat e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar në një
6 gjuhë që ai e kupton dhe flet; konfirmoj se i akuzuari e
7 kupton aktakuzën; bindem se të drejtat e të akuzuarit, dhe
8 veçanërisht e drejta e tij për të pasur avokat mbrojtës, janë
9 respektuar; informoj të akuzuarin se brenda 30 ditësh nga dita
10 e seancës së sotme ai do të ftohet të vetëdeklarohet fajtor
11 ose i pafajshëm në lidhje me secilën akuzë të paraqitur në
12 aktakuzë. Në qoftë se i akuzuari dëshiron, ai mund menjëherë
13 të vetëdeklarohet në lidhje me fajësinë ose pafajësinë. Dhe së
14 fundi, do të caktoj data të tjera sipas nevojës në kryerjen e
15 detyrës, apo detyrave të mia si Gjykatës i Procedurës
16 Paraprake.

17 Pres nga palët që t'u përmbahen këtyre pikave, të cilat
18 unë do t'i trajtoj një nga një. Nëse palët dëshirojnë të
19 diskutojnë ndonjë pikë tjetër që nuk është paraparë në kuadër
20 të seancës së Paraqitjes së Parë, ftoj këto palë që këtë ta
21 bëjnë me anë të parashtrimeve me shkrim.

22 Së pari, z. Gucati, a mund t'ju kërkoj që të më
23 konfirmoni se e keni marrë Aktakuzën e Konfirmuar të datës 14
24 dhjetor 2020 në një gjuhë që e kuptoni dhe flisni?

25 I AKUZUARI GUCATI: Po, e kam marrë.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gucati.

2 Tani do t'i kërkoj Sekretares së Gjykatës t'i lexojë
3 akuzat e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar, sikurse
4 parashihet në nenin 39 të Ligjit dhe rregullën 92 të
5 Rregullores.

6 Urdhëroni znj. Sekretare.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
8 Gjykatës.

9 Në Aktakuzën e Konfirmuar, Prokurori i Specializuar
10 akuzon z. Hysni Gucati për veprat penale të mëposhtme:

11 Pika 1: Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e
12 detyrave zyrtare, me anë të kërcënimit të rëndë, e
13 ndëshkueshme në bazë të neneve 401(1) dhe (5) të Kodit Penal
14 të Kosovës dhe nenit 15(2) të Ligjit;

15 Pika 2: Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e
16 detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjen në veprimin e
17 përbashkët të një grupi, e ndëshkueshme në bazë të neneve
18 401(2) deri në (3) dhe (5) të Kodit Penal të Kosovës dhe nenit
19 15(2) të Ligjit;

20 Pika 3: Frikësim gjatë procedurës penale, e ndëshkueshme
21 në bazë të nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës dhe nenit 15(2)
22 të Ligjit;

23 Pika 4: Hakmarrje, e ndëshkueshme në bazë të nenit 388(1)
24 të Kodit Penal të Kosovës dhe nenit 15(2) të Ligjit;

25 Pika 5: Shkelje të fshehtësisë së procedurës, përmes

1 zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të
2 nxjerrë në procedura zyrtare, e ndëshkueshme në bazë të nenit
3 392(1) të Kodit Penal të Kosovës dhe nenit 15(2) të Ligjit;
4 dhe

5 Pika 6: Shkelje të fshehtësisë së procedurës, përmes
6 zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave
7 personale të dëshmitarëve të mbrojtur, e ndëshkueshme në bazë
8 të nenit 392(2) dhe (3) të Kodit Penal të Kosovës dhe nenit
9 15(2) të Ligjit.

10 Këto vepra penale u kryen midis më së paku 7 dhe 25
11 shtatorit 2020.

12 Në lidhje me këto vepra penale, ekziston dyshim i bazuar
13 mirë se z. Hysni Gucati mban përgjegjësi penale, në bazë të
14 nenit 16(3) të Ligjit për:

15 a. kryerje të veprave penale në pikat 1 deri në 6, në
16 bazë të nenit 17 të Kodit Penal të Kosovës;

17 b. në bashkëpunim me z. Nasim Haradinaj dhe të tjerë, në
18 veprat penale në pikat 1 dhe 3 deri në 6, në bazë të nenit 31
19 të Kodit Penal të Kosovës;

20 c. nxitje të kryerjes së veprave penale në pikat 1 deri
21 në 6, në bazë të nenit 32(1) të Kodit Penal të Kosovës;

22 d. nxitje të veprave penale në pikat 1 deri në 6, në
23 bazë të nenit 32(2) të Kodit Penal të Kosovës, dhe u tentua
24 kryerja e këtyre veprave penale;

25 e. nxitje të veprave penale në pikat 1 deri në 3 dhe në

1 pikën 6, në bazë të nenit 32(3) të Kodit Penal të Kosovës, dhe
2 vepra të tilla penale nuk u kryen dhe as u tentua të
3 kryheshin;

4 f. ndihmë në kryerjen e veprave penale në pikat 1 deri
5 në 6, në bazë të nenit 33 të Kodit Penal të Kosovës;

6 g. marrëveshje për kryerje së bashku me Nasim Haradinaj
7 dhe të tjerë, të veprave penale në pikat 1 deri në 6, në bazë
8 të nenit 35 të Kodit Penal të Kosovës; dhe/ose

9 h. tentim për të kryer veprat penale në pikat 1 deri në
10 4 dhe në pikën 6, në bazë të nenit 28 të Kodit Penal të
11 Kosovës.

12 Ju faleminderit.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.
14 Sekretare.

15 Z. Gucati, dua t'ju rikujtoj se ky nuk është momenti për
16 të kundërshtuar akuzat, por thjesht për të konfirmuar se i
17 kuptoni ato. Do të keni mundësi të bollshme për të
18 kundërshtuar akuzat me ndihmën e avokatit tuaj mbrojtës.

19 Z. Gucati, a i kuptuat akuzat e paraqitura në Aktakuzën e
20 Konfirmuar të cilat ua lexoi Sekretarja e Gjykatës?

21 I AKUZUARI GUCATI: Po, i kam kuptuar.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gucati.

23 Tani do t'ju informoj për të drejtat që ju takojnë para
24 kësaj Gjykate.

25 Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Rregullorja e

1 Procedurës dhe e Provave ju garantojnë disa të drejta. Unë do
2 t'ju lexoj më të rëndësishmet.

3 E para, prezumoheni i pafajshëm deri në vërtetimin e
4 fajësisë suaj përtej dyshimit të arsyeshëm. Në marrjen e
5 vendimit mbi akuzat kundër jush, ju keni të drejtën e një
6 gjykimi të drejtë dhe të shpejtë në varësi të masave të
7 urdhëruara për mbrojtjen e viktimave dhe të dëshmitarëve.

8 Keni të drejtën të informoheni në kohë dhe në hollësi në
9 një gjuhë që e kuptoni dhe flisni për natyrën dhe arsyen e
10 akuzave kundër jush.

11 Keni të drejtën për të pasur kohë dhe mundësi të
12 mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes suaj, si dhe për të
13 komunikuar me avokatin mbrojtës që keni zgjedhur vetë.

14 Keni të drejtë që të gjykoheni brenda një periudhe të
15 arsyeshme kohore.

16 Keni të drejtën që të gjykoheni në praninë tuaj dhe të
17 mbroheni nëpërmjet avokatit tuaj mbrojtës.

18 Keni të drejtën t'ju caktohet një avokat mbrojtës pa
19 pagesë në qoftë se nuk dispononi mjete të mjaftueshme
20 financiare për pagesën e tij.

21 Keni të drejtë që t'u bëni pyetje ose dikush tjetër t'u
22 bëjë pyetje në emrin tuaj dëshmitarëve, si edhe të kërkon
23 praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emrin tuaj.

24 Keni të drejtën e ndihmës së një përkthyesi falas nëse
25 nuk e kuptoni dhe flisni gjuhën që përdoret në Gjykatë.

1 Keni të drejtën që të mos detyroheni të dëshmoni kundër
2 vetes apo të pranoni fajësinë.

3 Keni të drejtën të qëndroni i heshtur dhe nuk do të
4 nxirret përfundim negativ nga heshtja juaj.

5 Keni gjithashtu të drejtën të bëni deklaratat pa betim në
6 lidhje me çështjen, dhe mund të paraqiteni vetë si dëshmitar
7 nën betim.

8 Keni të drejtë të paraqisni mocioneve paraprake për të
9 kundërshtuar juridiksionin e Dhomave të Specializuara, për të
10 pretenduar mangësi në formën e aktakuzës, dhe për të kërkuar
11 ndarjen e akuzave.

12 Keni të drejtë që brenda 30 ditësh nga dita e seancës së
13 sotme, të merrni materialin mbështetës të aktakuzës së
14 parashtruar për konfirmim.

15 Keni të drejtën të merrni të gjitha deklaratat e
16 dëshmitarëve që Prokuroria synon t'i thërrasë për të dhënë
17 dëshmi gjatë gjykimit në një gjuhë që e kuptoni dhe flisni,
18 përkatësisht, në gjuhën shqipe.

19 Keni të drejtë të merrni menjëherë çfarëdo informacioni
20 që mund të sugjerojë në mënyrë të arsyeshme pafajësinë tuaj
21 apo të zbusë fajësinë tuaj, apo të ndikojë në besueshmërinë e
22 provave të Prokurorit të Specializuar, në momentin kur ai
23 informacion është nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë e
24 Prokurorit.

25 Keni të drejtë të gjitha materialet dhe provat apo faktet

1 që ka Prokurori i Specializuar t'ju jepen përpara dhe gjatë
2 procedurave. Kjo e drejtë kufizohet vetëm nga kufizime që janë
3 rreptësisht të nevojshme dhe kur janë në fuqi mbrojtjet
4 kundërbalancuese.

5 Keni të drejtë që të mos mbaheni në paraburgim për një
6 periudhë të paarsyeshme para fillimit të gjykimit, të kërkon
7 rishikimin e vendimeve në lidhje me paraburgimin, dhe t'i
8 apeloni ato vendime përpara Gjykatës së Apelit.

9 Keni të drejtë të apeloni drejtpërsëdrejti përpara
10 Gjykatës së Apelit një vendim mbi mocione paraprake që
11 kundërshtojnë juridiksionin e Dhomave të Specializuara.

12 Dhe keni të drejtë të kërkon leje për apelimin e
13 vendimeve të tjera.

14 Z. Gucati, ju i dëgjuat të drejtat më të rëndësishme që
15 ju takojnë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi të Dhomave
16 të Specializuara. A i keni të qarta këto të drejta?

17 I AKUZUARI GUCATI: Po, i nderum.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Gucati.

19 Ju informoj se në bazë të nenit 21(5) e Ligjit, ju nuk
20 mund të përfaqësoni vetveten por duhet të përfaqësoheni nga
21 mbrojtësi i specializuar.

22 Kam për detyrë, si Gjykatës i Procedurës Paraprake, të
23 siguroj që e drejta juaj për avokat mbrojtës të respektohet.
24 Për këtë qëllim kam mbajtur shënim parashtrimin e
25 Administratores që më informon për caktimin e kushtëzuar të

1 avokatit mbrojtës. Nga raporti i Administratores dhe
2 parashtrimet e Mbrojtjes suaj, ju përfaqësoheni jo vetëm për
3 qëllimet e kësaj seance paraprake por edhe për të gjithë
4 procedurat, në bazë të seksionit 14 të Direktivës për
5 Mbrojtësit.

6 Z. Gucati, a mund të konfirmoni që avokati juaj është
7 caktuar për të gjithë kohëzgjatjen e këtyre procedurave?

8 I AKUZUARI GUCATI: Po.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë, nga kjo rrjedh që
10 i akuzuari përfaqësohet nga mbrojtësi.

11 Tani do t' i kthehem mundësisë që i akuzuari të
12 vetëdeklarohet në lidhje me fajësinë ose pafajësinë nëse
13 dëshiron, në përputhje me rregullën 92.

14 Z. Gucati, brenda 30 ditësh nga data e sotme, ju do të
15 ftoheni të vetëdeklaroheni i pafajshëm ose i fajshëm, në
16 lidhje me akuzat në Aktakuzën e Konfirmuar. Nëse dëshironi
17 mund ta bëni këtë menjëherë, që të vetëdeklaroheni.

18 Pra, desha t' ju pyes z. Gucati, nëse e keni pasur
19 mundësinë të diskutoni akuzat në Aktakuzën e Konfirmuar me
20 avokatin tuaj, dhe nëse jeni i gatshëm të vetëdeklaroheni në
21 lidhje me fajësinë apo pafajësinë sot. Ju lutem, në qoftë se
22 do të bëni këtë, çohuni në këmbë kur të vetëdeklaroheni.

23 I AKUZUARI GUCATI: Para se të deklaroni, më lejoni
24 Gjyqtar, nëse keni mundësi, të m' i falni dy minuta kohë për
25 një deklaratë të shkurt.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Gucati, ju lutem çohuni
2 në këmbë.

3 I AKUZUARI GUCATI: Unë Hysni Gucati dhe bashkëlufëtëtarët
4 e mi kemi mbrojtur pragun e shtëpisë dhe atdheun tonë. Dhe si
5 pasojë unë jam plagosur më 3 qershor 1999, dhe sot jam invalid
6 i luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

7 Ne nuk e kemi pushtuar Serbinë. Ne jemi të pafajshëm. Unë
8 kam të drejtën e lirisë dhe të shprehjes. Dhe të drejtën të
9 shprehjes të mendimit -- mendimet e mia. Është e drejtë e imja
10 që në mënyrë të ligjshme të mbroj vlerat e kombit shqiptar dhe
11 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe do të vazhdoj t'i mbroj
12 këto vlera deri në fund.

13 I nderumi Gjyqtar, në të gjitha pikat që mu lexuan deri
14 tash, e ndiej veten të pafajshëm dhe plotësisht i pafajshëm.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gucati.

16 Një sqarim, sepse e kemi pasur dhe këtë problem përpara,
17 ju thatë që "ndjehem i pafajshëm". A mund të thoni që
18 vetëdeklaroheni i pafajshëm në lidhje me aktakuzën?

19 I AKUZUARI GUCATI: Z. Gjyqtar, deklarohej i vetë i
20 pafajshëm në të gjitha pikat që më kanë veshur mua.

21 Faleminderit.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani të kaloj te gjuha e
23 punës e procedurës.

24 Në urdhrin për caktimin e datës dhe të kohës së
25 Paraqitjes së Parë, unë vendosa që gjuha e punës e këtyre

1 procedurave do të jetë anglishtja.

2 Unë i informoj palët se të gjitha udhëzimet dhe
3 instruksionet që janë përcaktuar në vendimin e 29 tetorit
4 2020, mbeten në fuqi përgjatë gjithë kohës së Procedurës
5 Paraprake.

6 Në këtë moment, tani u kërkoj palëve nëse kanë çështje të
7 tjera për të ngritur. I kujtoj palët që të njoftojnë
8 paraprakisht nëse ndonjë prej parashtrimeve të tyre do të
9 kërkojë nxjerrjen e materialeve konfidenciale në mënyrë që të
10 merren masat e duhura.

11 Znj. Prokurore.

12 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nga ana e Prokurorisë nuk kemi
13 asnjë çështje për të ngritur.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

15 Mbrojtësi.

16 Z. REES: [Përkthim] Dy çështje i nderuar Gjykatës.

17 E para ka të bëjë me datën e Konferencës për Ecurinë e
18 Çështjes. Ju kërkuat që të bënim parashtrime verbale sot në
19 lidhje me atë datë. Duke marrë parasysh që data 7 janar, që
20 është e enjte, mund të jetë data e mundshme për atë seancë.

21 Puna është që për shkak të angazhimeve profesionale që
22 kam, unë nuk mund të vij atë datë por mund të vij më datën 8
23 janar, ditën e nesërme, si unë ashtu dhe z. Bouden. Unë e
24 diskutova këtë çështje edhe me avokatin e z. Haradinaj dhe ne
25 ramë dakord. Dhe e kuptova prej tij që data 8 janar është e

1 përshtatshme edhe për të edhe për Zyrën e Prokurorit të
2 Specializuar.

3 Pra, do të kërkoja në lidhje me këtë Konferencë për
4 Ecurinë e Çështjes që data të caktohet më 8 janar.

5 Çështja tjetër që desha të ngre, është -- ka lidhje me
6 rishikimin e masës së paraburgimit që duhet të bëhet më datë
7 27 dhjetor. Në përputhje me udhëzimin që keni dhënë ju z.
8 Gjykatës më përpara, ne kemi dorëzuar parashtime me shkrim.
9 Ato u ngarkuan në sistemin 'Legal Workflow' sot në mëngjes,
10 ose në pasditen e hershme.

11 Në fund të këtyre parashtimeve ne kemi kërkuar në
12 paragrafët prej 31-34, që të bëhet një seancë me gojë --
13 parashtimesh me gojë në lidhje me atë rishikim. Ju keni dhënë
14 udhëzim më përpara në lidhje me këto parashtime që edhe ZPS-
15 ja, d.m.th., Zyra e Prokurorit të Specializuar edhe Mbrojtja e
16 z. Haradinaj dhe z. Gucati të japin parashtimet e tyre me
17 shkrim në të njëjtën datë, që ishte data sot.

18 Por ne nuk kemi marrë njoftim paraprak për këto
19 parashtime në lidhje me rishikimin e paraburgimit nga
20 Prokurori i Specializuar.

21 Sigurisht, paraburgimi ka të bëjë me të drejtën themelore
22 të z. Gucati për të qenë i lirë, dhe duhet që Prokurori i
23 Specializuar të justifikojë, të përlligji vazhdimin e
24 paraburgimit për të. Dhe siç e keni thënë edhe ju më përpara,
25 i nderuar Gjykatës, në udhëzimet tuaja të mëparshme ju keni

1 pranuar që z. Gucati duhet t'i jepet i gjithë informacioni i
2 duhur në mënyrë që të bëhet një rishikim i efektshëm i
3 paraburgimit të tij. Dhe ne parashtrojmë që, në fillim
4 Prokurori duhet të japë njoftim se çfarë parashtrimesh ka, dhe
5 pastaj ne mund të kemi mundësi të bëjmë komente për të në
6 lidhje me të gjitha kategoritë e informacionit.

7 Ne themi që duhet të bëhet seancë gojore në mënyrë që z.
8 Gucati të ketë mundësi t'i përgjigjet parashtrimeve që ka bërë
9 Prokurori i Specializuar, dhe shtoj që edhe z. Haradinaj duhet
10 të bëjë parashtrimet e veta në lidhje me të njëjtën çështje.
11 Sigurisht, kjo do t'u lejonte të gjitha palëve që të ngrenë
12 çfarëdo çështje që kanë me ju dhe kjo do të ndikojë në marrjen
13 e vendimit efektiv në bazë të rishqyrtimit të çështjes.

14 Ne kemi propozuar që të na jepet një seancë me
15 videolidhje më 21 ose më 23 dhjetor. Kaq kisha për sa i përket
16 seancës së parashtrimeve me gojë në lidhje me paraburgimin.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

18 Znj. Prokurore, në lidhje me këtë kërkesë të fundit të z.
19 Rees, ju lutem.

20 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Unë desha të them që avokati
21 mbrojtës është njoftuar për urdhrin e Gjykatësit të Procedurës
22 Paraprake që më datën 9 dhjetor 2020. Në atë kohë palëve iu
23 kërkua që të bënin parashtrime me shkrim në lidhje me
24 paraburgimin në të njëjtën kohë.

25 Në qoftë se Mbrojtësi kishte një ide që dëshironte një

1 diferencim në afatet kohore, se kur do t'i dorëzonin
2 parashtrimet palët, këtë kërkesë mund ta kishte bërë më herët.

3 Në lidhje me këtë, kjo seancë e parashtrimeve me gojë,
4 sipas mendimit tonë, nuk është e nevojshme në këtë fazë sepse
5 të dyja palët i kanë paraqitur parashtrimet e tyre me shkrim
6 dhe të gjitha çështjet i janë paraqitur Gjykatësit të
7 Procedurës Paraprake për të marrë vendimin e tij.

8 Dua të theksoj që Gjykata e Apelit në vendimin e datës 9
9 tetor 2020, ku z. Gucati bëri apel kundër vendimit të
10 Gjykatësit të Vetëm, për sa i përket kërkesës për lirim me
11 kusht, duam të vëmë në dukje që kjo është një çështje
12 diskrecionale dhe mund të shihet si e panevojshme që t'i
13 paraqitet. Pra, informacioni që ka Gjykata është i mjaftueshëm
14 për marrjen e vendimit në lidhje me këtë. Faleminderit.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

16 Z. Rees.

17 Z. REES: [Përkthim] Në Gjykatën e Apelit, z. Gucati
18 kishte mundësinë të përgjigjej me shkrim përgjigjes të Apelit
19 të paraqitur nga Prokuroria përpara se Trupi Gjykues të merrte
20 vendim.

21 Ne përsërisim dhe i përmbahemi kërkesës për një seancë me
22 gojë të propozuar në një nga tre ditët e ardhshme, nga e hëna
23 në të mërkurën, përmes videolinkut. Një alternativë do të
24 ishte që të paraqitej një përgjigje nga Prokuroria për
25 parashtrimet me shkrim të Mbrojtjes përpara se ju të merrni

1 vendim.

2 E ngre këtë çështje sepse ne jemi në një pozicion tjetër
3 nga pikëpamja procedurale lidhur me -- krahasuar me atë
4 përpara Gjykatës së Apelit.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

6 Për këtë çështje do të jap vendim me shkrim sot pasdite,
7 apo të hënën në mëngjes maksimumi.

8 Tani dua të flas për çështjen e Konferencës lidhur me
9 ecurinë e çështjes, sidomos për datën.

10 Vërtet e kam pasur qëllim që ta parashikoj për 7 janar.
11 Qëllimi është që të shikohet ku jemi me ecurinë e çështjes,
12 dhe të shkëmbehen mendime midis palëve për të siguruar
13 gjykimin e shpejtë.

14 Një pyetje z. Rees. Në qoftë se do ta linim për datën 8,
15 të premten, do të ishit i disponueshëm në mëngjes apo pasdite?

16 Z. REES: [Përkthim] Po, do të isha. Ne mund të marrim
17 pjesë edhe nga larg si avokat mbrojtës, edhe z. Gucati.

18 Megjithatë, ne duam ta pyesim -- t'ju kërkojmë që më mirë
19 ta merrnit parasysh pasditen. Ne, në qoftë se ju vendosni për
20 paradite, sigurisht që do ta bëjmë, por do të ishte më mirë
21 pasdite.

22 Duke pasur parasysh situatën aktuale të kufizimeve të
23 COVID-it, në këto rrethana do të kërkonim nga Gjykata që
24 pjesëmarrja të bëhej nga larg për të dy, dhe për ne dhe për z.
25 Gucati. Do të ishim pra, siç thashë, edhe në mëngjes edhe

1 pasdite në 8 janar të disponueshëm.

2 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] Faleminderit.

3 Z. Gucati, dua t'ju kujtoj, pas këtyre që tha avokati
4 jua, se keni të drejtën të merrni pjesë në Konferencën për
5 Ecurinë e Çështjes me avokatin.

6 Por, me pëlqimin tuaj me shkrim dhe pasi të jeni
7 këshilluar me avokatit tuaj, sipas rregullës 96(2), ju mund të
8 merrni pjesë ose vetë personalisht, dhe avokati jua të marrë
9 pjesë me videolink; ose përmes avokatit, dhe ju të merrni
10 pjesë nëpërmjet konferencës me video; po mund të bëhet edhe në
11 mungesën tuaj, me praninë e avokatit apo që të marrë pjesë
12 nëpërmjet videolinkut.

13 Tani i kërkoj Prokurorisë që të më japë një datë, për
14 mendimin e tyre për Konferencën.

15 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Çdo datë do të ishte pa problem
16 për ne.

17 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] E mbajta shënim. Do të jap
18 një urdhër shumë shpejt për datën dhe do të përfshij edhe
19 agjendën.

20 Pas Konferencës për Ecurinë e Çështjes do të jap një
21 vendim për detyrimet e Prokurorisë, në bazë të rregullës 102,
22 për bërjen e njohur të materialeve.

23 Në këtë urdhër do t'u bëj thirrje palëve të paraqesin
24 parashtrime me shkrim përpara sesa të bëhet seanca e dëgjimit
25 për këtë temë dhe për çdo çështje që ata duan të ngrenë.

1 Z. Gucati, meqenëse jeni në paraburgim, dua t'ju informoj
2 se mund ta kundërshtoni paraburgimin në përputhje me rregullën
3 57.

4 Siç thashë dje në vendimin për ripërcatimin e datës, i
5 bëj thirrje Mbrojtjes së z. Gucati të vërë në dukje nëse
6 kërkesa për shtyrjen e dëgjimit, që ka të bëjë me materialin
7 F0079//siç u përkthye// i paraqitur si konfidencial, mund të
8 riklasifikohet si publik, apo nëse Mbrojtja ka për qëllim të
9 paraqesë një version të redaktuar të saj.

10 Z. Rees.

11 Z. REES: [Përkthim] Do të na lejoni ta shqyrtojmë këtë, i
12 nderuar Gjykatës, dhe t'ju japim mendimin tonë me parashtrime
13 me shkrim?

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Padyshim. Faleminderit.

15 Dua t'u kujtoj palëve se parashtrimet duhen bërë si
16 publike, përveçse kur ka arsye që të përmbajnë materiale
17 konfidenciale. Në këtë rast, sipas rregullës 82, pala duhet të
18 parashtrojë arsyet për klasifikimin e një materiali
19 konfidencial.

20 Për më tepër, kur e urdhëroj një palë të bëjë parashtrime
21 apo të vënë në dukje pikëpamjet e tyre për riklasifikimin e
22 parashtrimeve të tyre, kjo do të thotë thjesht se palët ftohen
23 të deklarojnë mendimet e tyre për këtë çështje. Parashtrimet
24 nuk mund të riklasifikohen *proprio motu* nga palët por vetëm
25 përmes udhëzimeve gjyqësore.

1 Dua të vë në dukje gjithashtu se kam vënë re me shqetësim
2 gjatë ditëve të fundit, se media ka raportuar informacion
3 lidhur me vendimin e konfirmimit dhe për akuzat në Aktakuzën e
4 Konfirmuar, që në fakt nuk ishin bërë ende publike në atë
5 kohë. Në këtë drejtim, dëshiroj t'u kujtoj palëve dhe të
6 akuzuarit të respektojnë natyrën konfidenciale të disa prej
7 informacioneve që përmbajnë këto procedura.

8 Paraqitja e Parë e z. Gucati bëhet sot, në këtë moment,
9 pas një vendimi fillestar dhe një i dytë që ka përcaktuar
10 kohën dhe datën. Ndërsa në këtë moment, duke marrë parasysh se
11 kjo është Paraqitja e Parë e të akuzuarit, unë i lejova këto
12 ndryshime si rast përjashtimor. Kërkesat e ardhshme për
13 ripërcaktimin e datave do të lejohen vetëm për arsye të forta.
14 Ripërcatimin i datës përfshin një punë shtesë shumë të madhe
15 për shumë njësi të Gjykatës, dhe prandaj këto raste duhet të
16 mbahen në minimum.

17 Dhe me këto fjalë i falënderoj palët dhe ju premtoj që
18 mund të ripërcaktojmë Konferencën për Ecurinë e Çështjes në
19 dijeninë e plotë të palëve.

20 Së dyti, dua të them se pushimi i Gjykatës fillon në
21 datën 21 dhjetor dhe përfundon në datën 1 janar 2021. Gjatë
22 kësaj periudhe unë do t'i përgjigjem vetëm çështjeve urgjente.
23 Çështjet jourgjente i duhen drejtuar Gjykatës pas pushimit.

24 Në qoftë se asnjë nga palët nuk ka gjë për të shtuar, e
25 deklaroj seancën të mbyllur. I falënderoj palët, sekretarinë.

1 Falënderoj përkthyesit, teknikët, stenografin, sigurinë, të
2 gjithë që kanë ndihmuar.

3 Me kaq mbaron seanca.

4 --- Seanca e Paraqitjes së Parë përfundon në
5 orën 14.37

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25